



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 14 QERSHOR 2012

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 14. JUNA 2012. GODINE

QERSHOR - JUN
2012

R e n d i i d i t ë s

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

D n e v n i r e d

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o slepim i delimično slepim osobama,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o menadžiranju javnih finansija i odgovornostima.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare. E kemi kuorumin për t'ia filluar punës.

Fillojmë me pikën e parë:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Të pranishëm i kemi 72 deputetë.
Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, diskutimet në emër të grupit parlamentar 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta. Prandaj, fillojmë menjëherë.

Nëse shkojmë sipas rendit të paraqitur në ekran, fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Falemnderit, kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Institucionet publike shëndetësore në vend janë duke u degraduar çdo ditë e më shumë, ndërsa gjendja në këto institucione është shqetësuese. Mungesa e madhe e barnave dhe materialit shpenzues, laborator i jashtëzakonisht i varfër, mosfunksionimi i aparaturës ekzistuese, listat e gjata të pritjes, janë vetëm disa nga problemet e shumta në këto institucione.

Si shkas për këtë diskutim e kam marrë mosfunksionimin e aparatit të koronarografisë të kabinetit të Kardiologjisë Invazive, tash e tre muaj. Dhe, nuk është hera e parë që kjo aparaturë e shtrenjtë në QKUK nuk punon në periudha disamujore. Një pyetje në të cilën nuk kam përgjigje është pse duhen periudha të stërzgjatura për rifunksionalizimin e saj?

Ndërkaq çfarë ndodh me të sëmurët që kanë nevojë t'i nënshtrohen kësaj procedure? Ata duhet të presin gjatë e gjatë derisa QKUK-ja të arrijë ta futë në ripërdorim këtë aparaturë, apo pacientët më fatlumë, me status më të mirë social, i kanë dyert e hapura në institucionet e bollshme shëndetësore në vend që e ofrojnë këtë shërbim, apo orientohen edhe jashtë vendit.

Përderisa në institucionet publike pothuajse asgjë nuk funksionon, apo funksionon me shumë vështirësi, në institucionet private, përkundrazi, krijohet terren i favorshëm që gjithçka të funksionojë lehtë. Madje, me anë të një udhëzimi administrativ, të lëshuar këtë vit nga Ministria e Shëndetësisë, janë bërë lehtësime tepër të mëdha për leje pune në Kosovë të mjekëve që vijnë nga jashtë, pa kërkuar nga ata praktikisht kurrfarë kriteresh.

Këta mjekë, veprimtarinë e tyre e kryejnë në institucionet private në vend, ndërkohë që asnjëherë nuk sillen ekspertë nga jashtë, që punën e tyre ta kryejnë në institucionet publike dhe ta aftësojnë kuadrin vendor, posaçërisht për lëmenj deficitarë. Kjo gjë e dëshmon qartë qëllimin për përfitime materiale në hallka të ndryshme, e assesi për ngritjen e nivelit shëndetësor në vend.

Një politikë e tillë, në kushte krejtësisht të pabarabarta të konkurrencës, konsideroj se në afat të gjatë do të ndikojë në rënie edhe më të madhe të nivelit të shëndetësisë kosovare.

Në media shohim se për çdo ditë inaugurohen spitale moderne private, të ashtuquajtura: amerikane, gjermane, turke etj., ndërsa nga QKUK-ja na shfaqen vetëm lajme tronditëse.

Nuk është se personalisht kam ndonjë gjë kundër zhvillimit të sektorit privat në vend, mirëpo në mungesë të sigurimeve shëndetësore, luksin e këtyre institucioneve mund ta gëzojë vetëm një pjesë e vogël e popullatës sonë. Ndërkohë, kush duhet të mendojë për shumicën e popullatës së varfër të ne? Ata duhen të përballen me kaosin marramendës që mbretëron në institucionet publike në vend.

Nuk e di se kujt i konvenon një gjë e tillë, por popullit të Kosovës sigurisht që jo. Pakënaqësia e popullatës në raport me shëndetësinë e vendit vërehet në bisedë me çdo qytetar, që ballafaqohet me nevojën për shërbime shëndetësore.

KRYETARI: Falemnderit! Edhe 20 sekonda, po e bëjmë një përjashtim për ju.

AURORA BAKALLI: Edhe sa duhet të pritet që kjo çështje kaq e ndjeshme të trajtohet me prioritet?

Prandaj, si deputete e Kuvendit të Kosovës, nga kjo foltore u bëj thirrje Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë që të punojnë seriozisht, sepse është koha e fundit për ta shpëtuar shëndetësinë në vend. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,

Unë po e marr fjalën sot për t'i rikonfirmuar disa angazhime që Lidhja Demokratike e Kosovës i ka në lidhje me shtetformimin në Kosovë dhe në lidhje me aktivitetet e saj për të ndikuar sa më shumë që të jetë e mundur në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve të Kosovës.

Ju mund të jeni të informuar se sot në Bruksel, një delegacion i Republikës së Kosovës, i përbërë edhe nga përfaqësues nga opozita, shkon për ta marrë udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave. Kjo tingëllon mirë, tingëllon edhe interesant, mirëpo çështja është se çka do të ndodhë sot atje? Dhe, për këtë sot unë po e marr fjalën, sepse ne si shtet dhe si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës duhet të punojmë për të mirën dhe në interesin e qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, Lidhja Demokratike e Kosovës angazhohet që të gjitha ligjet dhe të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren nga Parlamenti i Kosovës dhe të gjitha institucionet ku ajo është e përfaqësuar, do t'i kalojë të gjitha ligjet dhe vendimet që kanë të bëjnë me liberalizimin e vizave.

Mirëpo, duhet t'i kemi parasysh disa elemente, dhe ndër elementet kryesore është se procesi i liberalizimit të vizave është një proces i veçantë për Kosovën dhe ka kushte jashtëzakonisht të rënda për Kosovës dhe këtu duhet t'i kemi parasysh se cilat janë ato kushte dhe sa është e aftë kjo Qeveri që t'i plotësojë ato kushte.

Kushti i parë është luftimi i krimit të organizuar. Por, kjo Qeveri nuk është e aftë që ta luftojë krimin e organizuar.

Kushti i dytë është luftimi i korrupsionit. Kjo Qeveri nuk është e aftë ta luftojë korrupsionin, sepse është vetë pjesë e saj, nëse jo udhëheqësi kryesor.

Kushti i tretë është luftimi i trafikimit me njerëz. Kjo Qeveri dhe përfaqësuesit e saj janë të përfshirë në këtë proces.

Kushti i katërt është luftimi i trafikimit me drogë. Luftimi i trafikimit me drogë ka probleme, sepse ju e dini që në stacionet e policisë, në dhomat e dëshmive, vidhen dëshmi dhe sasi e konsiderueshme të drogës.

Kushti i pestë është sundimi i ligjit dhe shteti i së drejtës. Ju e dini se të gjitha raportet ndërkombëtare dhe të gjitha vlerësimet thonë se në Kosovë ka probleme të mëdha me sundimin e shtetit të së drejtës dhe sundimin e ligjit.

Prandaj, ne si shoqëri duhet t'i kemi parasysh këto elemente se rruga e Kosovës drejt liberalizimit të vizave, fatkeqësisht, do të jetë e gjatë, fatkeqësisht do të jetë e vështirë, fatkeqësisht është një vendim nga i cili pritet shumë prej qytetarëve të Kosovës, sepse mungon shpresa për zhvillim, mungon shpresa për punësim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të Grupit, ia vazhdojmë kohën.

ARBEN GASHI: ...mungon shpresa për një jetë më të mirë në Kosovë dhe të gjitha këto probleme vijnë si rezultat i keqeverisjes. Prandaj, edhe një herë, duke marrë parasysh situatën kritike në të cilën ndodhet Kosova, në aspektin e zhvillimit ekonomik, në aspektin e luftës kundër krimit të organizuar, në aspektin e luftës kundër korrupsionit, në aspektin e luftës kundër trafikimit me njerëz dhe me drogë dhe në aspektin e sundimit të rendit dhe të ligjit, unë, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, angazhohem dhe jap vullnetin e Lidhjes Demokratike të Kosovës që të ndihmojë maksimalisht në zbatimin e rendit dhe të ligjit dhe në kalimin e të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me integritet evropiane dhe me sundimin e rendit dhe të ligjit.

Mirëpo, duhet ta kemi parasysh se këtu duhet të ekzistojë vullneti dhe angazhimi i Qeverisë që të luftohet krimi i organizuar dhe të gjitha ato kushte thelbësore, të cilat i janë vendosur Kosovës. Fatkeqësisht, janë kushte shumë të rënda, për të cilat unë kam dyshimin dhe bindjen se kjo Qeveri nuk mund t'i realizojë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Unë desha të fokusohem në një temë tjetër, por parafolësi ynë në mënyrë hipotetike shtroi disa çështje që nuk është asgjë e re dhe më shumë për t'u reklamuar në televizion, ndërsa qëndrimet e Qeverisë janë të dakorduara dhe të angazhuara në mënyrë permanente për të gjitha këto dukuri, për të cilat ai foli. Mirëpo, se çfarë bën Lidhja Demokratike ne e dimë, po i tregon edhe elektorati, prandaj nuk ju uroj sukses shumë që të afirmoheni tjera herë. Dhe, shumë çështje të cilat i ngriti parafolësi ynë si një ish-polic ka më shumë fakte se sa që flet në mënyrë hipotetike këtu të ngrejë dyshime të ndryshme dhe të cilat e krijojnë një mjegull për opinionin e gjerë.

Çështja për të cilën desha të flas është çështja e fabrikës “Sharrcem”, e cila është bërë temë këto ditë dhe mendoj që privatizimi i kësaj fabrike është bërë në mënyrë jo të rregullt, e tani së fundi Ministria e Tregtisë dhe Industrisë mundohet t'i japë favore, të cilat mendoj se janë një shkelje e të drejtave të konkurrencës, prandaj kjo ministri duhet të aplikojë standarde të cilat duhet të jenë të qëndrueshme dhe të bazuara.

Unë do të isha befasuar nëse fabrika “Sharrcem” do të vlerësohej nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për monitorimin e cilësisë, për ndotjen e ambientit, për kualitetin e shërbimeve dhe për produktin të cilin e nxjerr, e jo të favorizohet me një teknologji të vjetruar, sepse kur është futur në privatizim e ka ditur këtë dhe kjo kompani e mban monopolin në Ballkan.

Sot ndërtimi kontrollon nga “Titani” nëpërmjet çimentos në tërë Ballkanin, prandaj nuk duhet që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të përzihet në këtë çështje, sepse neve nga ngre shumë pyetje, nga të cilat mund të dyshojmë edhe për keqpërdorime serioze, e për të cilat ministrja është angazhuar zëshëm, derisa është bërë ministre, që të mos futet në këto lojëra, të cilat mendoj se janë jashtëzakonisht të dëmshme edhe për autoritetin qeveritar, por edhe për kualitetin e konkurrencës në treg.

Unë kisha kërkuar që të anulohen ato vendime, të cilat janë bërë në drejtim të Republikës së Shqipërisë, të cilat janë të dëmshme, të cilat janë duke u politizuar dhe të cilat janë duke punuar në interes të përgjithshëm për interesat...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në këtë pikë nuk ka replikë, ju e dini këtë. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu. Nuk ka replikë, tema që e keni shtruar nxit replikë, por nuk është për këtë rend të ditës. Mësojeni njëherë e mirë. Liburn Aliu, në emër të Grupit të “Vetëvendosjes”.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Javën që shkoi, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ishte në një seminar në Stamboll, seminar ky që kishte të bënte me Ligjin e ndërtimit dhe me reformën e shtetit gjeorgjian në këtë fushë, e këtë prezantim na bënë vetë ekspertët gjeorgjianë, të cilët kishin qenë po ashtu edhe pjesë e kësaj reforme.

Ky prezantim për ne ishte me shumë interes, pasi Gjeorgjia ka qenë fjala që e ka përcjellë tërë procesin e miratimit dhe amendamentimit të Ligjit të ndërtimit të ne. Unë posaçërisht isha interesuar pikërisht për ato pika diskutabile, të cilat gjatë diskutimeve, gjatë trajtimit të ligjit nuk kishim asnjë përgjigje dhe për të gjitha këto çështje gjithmonë na merrej shembull Gjeorgjia. Dhe, doli që ne nuk e paskemi ligjin as si të Gjeorgjisë në shumë pika, e posaçërisht kur bëhet fjalë për kontrollin në fazat e projektimit dhe të ndërtimit.

Zotërinj, Ligji i ndërtimit, i miratuar në këtë Kuvend, lejon që ndërtesat në të cilat do të jetojë një numër i madh i familjeve, objektet të cilat në vendet e tyre do të punojnë shumë punëtorë, të mos kontrollohen profesionalisht as në fazën e projektimit, e as në fazën e ndërtimit. Unë prisja përgjigje nga ekspertët gjeorgjianë, që thuhet se na e kanë bërë ligjin, të na japin ata përgjigje.

Në vendin e tyre dhe si kudo në botë, projektet për objektet, që nga ato të banimit shumëbanesor dhe deri te fabrikat dhe konstruksionet e ndryshme problematike, kontrollohen nga ekspertët e licencuar, të cilët e marrin përgjegjësinë, kurse në fazat e ndërtimit mbikëqyrja profesionale në këto objekte është e detyrueshme dhe natyrisht me përgjegjësi ligjore. Përse ndodh kjo? Kjo ndodh për shkak të sigurisë së qytetarit.

Tek ne, si ekspertët vendorë, si ata të cilët morën pjesë në punën e komisionit dhe në dëgjimin publik, një për një i kanë dhënë vërejtjet e tyre mjaft të qarta, e madje edhe ekspertët nga Gjeorgjia, që Qeveria i merr si shembull se do ta ndjekim rrugën e tyre si shtet, i shohin si të domosdoshme këto elemente në ligj. Dhe, konsideroj shumë thjesht se është bërë gabim dhe është tejet e rëndë që ka kaluar ky ligj me këso gabimesh te ne.

Gabimet e këtij ligji u bënë më të qarta në Stamboll, gjatë debateve që kishim me deputetët, përfaqësuesit e Ministrisë dhe ekspertët gjeorgjianë.

Për këtë ligj duhet ftuar në interpelancë ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të na sqarojë se si u bë që të draftohet pa asnjë debat me palët që përfshihen, si u bë që u injoruan parimet elementare të sigurisë dhe si u bë të dalë ky ligj, e sot askush të mos marrë përgjegjësi për mungesën e këtyre parimeve?

Ky ligj duhet të kthehet, pasi e rrezikon qytetarin dhe e lejon degradimin e mjedisit. Unë nuk po hyj në temën se si e rrit korrupsionin, pasi në raport me sigurinë e qytetarëve është sekondare. Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës, me sa jemi të informuar, i kanë kërkuar Presidentes ta kthejë ligjin në rishqyrtim.

Si Grup Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” konsiderojmë se është një mundësi e mirë të ndryshohet diçka për të mirë në këtë ligj. Dhe, ne e përkrahim kthimin e këtij ligji në

rishqyrtim. Pra, i kërkojmë shkëlqesisë së saj, zonjës Presidente, ta kthejë në rishqyrtim këtë ligj, e po ashtu i ftojme të gjitha grupet parlamentare dhe deputetët ta bëjnë një gjë të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Dhe, ju e dini që Presidentja ka të drejtë t'i kthejë ligjet vetëm kur ato bien ndesh me Kushtetutën. Mos kërkonë që çdo ligj Presidentja ta kthejë. Presidentja nuk e ka me Kushtetutë të drejtën ta kthejë asnjë ligj që nuk është në kundërshtim me Kushtetutën. Ju deputetë, duhet ta dini këtë. Fjalën e ka deputeti Emin Gërbeshi.

(Ndërhyrje)

Jo, s'po e paragjykoj. Nëse një ligj nuk bie ndesh me Kushtetutën, Presidenti s'ka të drejtë ta kthejë atë. Këtë të drejtë ia jep Kushtetuta, s'mund t'ia japësh ti. Emin Gërbeshi e ka fjalën.

EMIN GËRBESHI: Falemnderit, kryetar!

Vendimi i fundit i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vendosjen e taksës ndaj çimentos së Shqipërisë është vendim tepër i çuditshëm dhe i dëmshëm, që do të krijojë barriera të reja në raportet tregtare ndërmjet shqiptarëve.

Duket se kjo është bërë me qëllim që jo ta mbrojë prodhimin vendor, siç thuhet, por për interesa të caktuara të klaneve dhe grupeve që duan ta dominojnë ekonominë. Duke vepruar kështu, ata po e dëmtojnë, jo vetëm ekonominë, por edhe kombin tonë. Kjo taksë prodhon efekte shumë negative në disa segmente.

E para, e çrregullon furnizimin e tregut me këtë lëndë shumë të rëndësishme për ndërtimtarinë, kur dihet se çimentoja e Shqipërisë është dukshëm më e lirë se ajo e "Sharrcemit" dhe se ky prodhues i Kosovës nuk i plotëson kërkesat e tregut. E rrit koston e ndërtimeve, ndikon në ngritjen e çmimeve tjera, përgjithësisht e rrezikon këtë sektor që është shumë i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës dhe për krijimin e vendeve të punës. Gjithashtu, kjo masë është në kundërshtim edhe me politikat e Qeverisë për zhvillimin ekonomik, të proklamuar disa herë këtu. Gjithashtu, ky vendim i ministres e rrit çmimin e këtij artikulli dhe e favorizon prodhuesin grek, i cili i ka në pronësi fabrikën "Sharrcem" dhe fabrikat tjera në Serbi e Maqedoni.

Nxit Shqipërinë që të veprojë ngjashëm me disa prodhime tona, rrezikon kontratat e arritura në këtë fushë ndërmjet firmave të Kosovës dhe Fabrikës të Fushë-Krujës, duke e rrezikuar kapitalin në para të gatshme dhe, ç'është më e dëmshme, i largon shqiptarët nga prodhimet shqiptare, duke i favorizuar prodhimet e huaja. I propozoj Qeverisë së Kosovës që ta anulojë menjëherë këtë vendim të dëmshëm dhe t'i trajtojë prodhimet e Shqipërisë si prodhime vendore, sepse vetëm kështu ne do ta lëmë anash retorikën false dhe do t'u kthehemi prodhimeve tona, duke i ndihmuar ekonominë dhe popullit tonë. Dhe, nëse nuk ndodh kjo, atëherë unë personalisht, si deputet, do të kërkoj dorëheqjen e ministres Mimoza Kusari dhe do të mundohem të paraqes në Parlament një mocion, nëpërmjet të cilit do të kërkoj që prodhimet e Kosovës dhe të Shqipërisë të njihen si

prodhime vendore dhe të hiqen të gjitha barrierat doganore dhe barrierat tjera për këto prodhime.

Vendimet e tilla të Qeverisë i trembin investitorët dhe e rrezikojnë stabilitetin ekonomik të vendit. Suksesi i një qeverie nuk matet nga përmasat makroekonomike apo nga ekonomia që ka një vend, por nga qeverisja e mirë e një vendi, e me sa po shoh dhe me sa po duket, kësaj Qeverie i mungon kjo qeverisje e mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Deputetja Kymete Bajraktari e ka fjalën.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie është mision dhe vizion i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Sa krijon kushte dhe ambient Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për ta arritur këtë mision? Problemet me të cilat përballet arsimit në Kosovë janë të shumta: siguria në shkollë, braktisja e shkollimit nga nxënësit, respektimi i të drejtave të fëmijëve, hapësira jo e mjaftueshme, numri i madh i nxënësve nëpër klasa etj. Problemi i cili deri më sot nuk është përmendur dhe ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e arsimit dhe edukimit është struktura e personelit mësimor, siç janë ngritja profesionale dhe gjendja shëndetësore e mësimdhënësve, e udhëheqjes së shkollës dhe punëtorëve ndihmës.

Mësuesja në depresion, mësimdhënësi në karrocë të invalidit, mësimdhënësi me probleme fasciale si pasojë e operimeve të rënda, mësimdhënësi me teke neurotike, punëtori ndihmës me tuberkuloz janë në kontakt të përditshëm me nxënësit, te të cilët ndikojnë në krijimin dhe formimin e tyre psikologjik dhe shëndetësor. Studimet e bëra nga psikologët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë konstatuar se nëse një mësimdhënësi me teke neurotike punon në mësimdhënie, atëherë tek ata nxënës për dy muaj formohen teket neurotike. Për shëndetin e mirë të nxënësve, i domosdoshëm është shëndeti i mirë i mësimdhënësit. Shtrohet pyetja: Çka duhet të bëjë Ministria e Arsimit me këto raste, në të cilat, për shkaqe të ndryshme të jetës, e jo me dëshirën e tyre, mësimdhënësit kanë ardhur në atë gjendje?

Kjo është një çështje që duhet trajtuar seriozisht, sepse jeta ka plot të papritura dhe Ministria e Arsimit dhe Qeveria duhet të kujdesen që në raste të tilla të bëjnë zgjidhje. Kërkoj nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë, që rastet në fjalë, e që në numër nuk janë pak, të trajtohen dinjitetshëm dhe për ta të krijohet buxhet që këta mësimdhënësit ta fitojnë të drejtën e pensionimit të parakohshëm, ose të drejtën e pensionimit invalidor.

Besoj se angazhimi i ministrit të Arsimit në këtë drejtim do të jetë maksimal dhe i shpejtë, sepse vetëm në komunën e Suharekës janë mbi 7 raste, në të cilat duhet intervenuar urgjentisht, meqë angazhimi i tyre në punë të mëtejshme do të ketë pasoja të pariparueshme në ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, si vizion dhe mision i arsimit në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Duda Balje e ka fjalën, në emër të Grupit.

DUDA BALJE: Javila sam se da vam sa ove Skupštinske bine saopštim problem Bošnjačke zajednice, koji se ponovo vezuje za nepoštovanje zakona, odnosno neispunjavanje prava koje nam zakonski pripada.

Već 7 godina od samog osnivanja dvosatno dnevni program na bosanskom jeziku Radio Kosova se čuje samo u Prištini na dodatne frekvencije Radio Kosova 99,2 megaherca.

Ovaj program se međutim ne čuje u sredinama primarne publike, odnosno tamo gde žive Bošnjaci, a to su opština, Prizren, Peć, Mitrovica i Dragaš, i to zbog nedostatka nacionalnih frekvencija. Na osnovu Zakona, RTK imamo pravo čujnosti na čitavoj teritoriji Kosova, odnosno imamo pravo po članu 6 da nam se omogući program o proporcionalnom smislu, kao i za sve zajednice koje žive na Kosovu.

Zakon Nezavisne Komisije za Medije nalaže da ova komisija putem licenciranja treba da dodeli dovoljne frekvencije za javne komitere da bi se omogućilo da stanovništvu Kosova pruža radio televizijsku pokriću do maksimalne moguće mere. Međutim, realnost nije takva, i to kom svih ovih godina nije se uspeo rešiti problem dobijena dodatnih nacionalnih frekvencija, kako bi se program mogao čuti i van Prištine, na mestima sa Bošnjačkim auditorijumu.

Program na Albanskom jeziku Radio Kosova se emituje na nacionalnim frekvencijama, tako da se on čuje u svim kosovskim gradovima. Slično je i sa programom na Srpskom jeziku, koji se emituje na talasima Blu-Skaj Radia koji se takođe čuje u svim gradovima. Povodom ovog problema obratili smo se Nezavisnoj Komisiji za Medije, KPM, koja praktično potvrdila naš problem i obratila se direktora Radio Kosova, g. Arbenu Fetoši, sa preporukom da ispoštuje Zakon.

Od g. Fetoši i svi drugih odgovornih lica očekujemo da shvataju i uvide na kršenje našeg zakonskog prava koje traje već 7. godina, i da će se potruditi da prekine diskriminacije i nađe rešenja za naš problem. To što mi nismo konfliktna zajednica, ne znači da ne znamo naše prava i da se za njih nećemo boriti. Problem imamo i u televizijskom emitovanju za vreme trajanja evropskog prvenstva u fudbalu ne emituju se vesti na bosanskom jeziku. A ako se ne emituju vesti na albanskom jeziku za vreme trajanja fudbalske utakmice, ne prouzrokuje veliki problem, jer se vesti na albanskom jeziku čuju više puta na dan, a za nas je veliki problem jer se naše vesti emituju jednodnevno i njihovo neemitovanje prouzrokuju veliki deficit u informacijama. Naravno, zbog nerazumevanja od strane uprave nije nam dodeljen neki drugi termin, niti nam je data mogućnost uključivanja u vreme emitovanja.

Naše emisije se u ovom slučaju ne emituju zbog fudbalskom prvenstva, a imalo je slučajeva kada su se prekidali zbog nekih drugih direktnih prenosa, otvaranje sajmov, i raznih drugih manifestacija. Pitamo se da bi li rešenje toga bila dodela stalnog rezervnog termina? Zbog svega navedenog, molimo kuću RTK da više obrati pažnju na naš problem i da prekine sa vršenjem diskriminacije i ispoštuje svoj zakon. Hvala vam!

KRYETARI: Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Çështja që unë dua ta ngre ka të bëjë me kompleksin e parkut nacional “Blinaja”.

Pa dyshim se ky park nacional mund të krahasohet me parqet nacionale të rajonit, i pasur edhe me florë edhe me faunë, por fatkeqësisht i pashfrytëzuar. Deri në një kohë të caktuar, ky park nacional ka qenë në shfrytëzim të FSK-së, ndërkaq tani mirëmbahet vetëm nga Ekonomia e Pyjeve, brenda Ministrisë së Bujqësisë.

Në të kaluarën, ky park nacional ka qenë nën përkujdesjen e institucioneve të Republikës së Kosovës. Andaj, unë angazhohem që institucionet e Republikës së Kosovës, por edhe Kuvendi, ta luajë rolin e vet që ta marrë nën përkujdesje këtë park nacional dhe ta shndërrojë në një rezidencë të Republikës së Kosovës, sepse ne kemi probleme me objekte, me infrastrukturë. Paramendojeni, të nderuar kolegë, nëse tash kur po bëhen këto ndërtime pranë objektit të Presidentes, vjen një president i vendeve evropiane në Kosovë, ne kemi problem për t’ia bërë protokollin çfarë duhet. Kurse në vendet tjera kjo çështje është zgjidhur edhe me qendrat rezidenciale, edhe me hapësirat tjera, që janë tipike për një shtet.

Në Ministrinë e Administratës Publike është i gatshëm projekti që parku nacional “Blinaja” të përdoret si qendër rezidenciale. Unë e di se në të kaluarën, Kuvendi i ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës e ka përdorur atë mjaft për aktivitetet e tij dhe angazhohem që ai projekt, i cili është i gatshëm në Ministrinë e Administratës Publike, të implementohet, në mënyrë që Kosova, sikur edhe shumë vende tjera, po e zëmë, mund ta shohim praktikën e Republikës së Shqipërisë, apo praktikën e Republikës së Malit të Zi, ku liderët e vendit i bëjnë shumë pritje zyrtare në ato hapësira. Kosova i ka këto bukuri dhe me përkujdesjen ndaj këtij parku, kjo pasuri kombëtare do të shfrytëzohet dhe do të ndihmohet pak edhe në punësimin e banorëve të Shalës së Drenicës dhe të fshatrave përreth, që me aq shumë fanatizëm e kanë mbrojtur këtë park nacional nga shkatërrimet e mundshme që kanë ndodhur edhe në parqet tjera nacionale. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Falemnderit!

Të nderuar deputetë,

Para disa muajsh, LDK-ja paralajmëroi se Ministria e Punëve të Jashtme po luan me numrin e njohjeve, duke e dëmtuar rëndë kështu këtë proces.

Muajin që shkoi, LDK-ja shprehimisht kërkoi nga MPJ-ja që t’i largojë nga ueb-faqja njohjet nga Uganda dhe Nigeria. Kjo kërkesë u përsërit ditë me radhë, por fatkeqësisht u injorua në tërësi nga MPJ-ja.

Këto njohje të paqena, fatkeqësisht, u vendosën edhe në ueb-faqen e institucionit që e udhëheq politikën e jashtme, pra të Presidentes së Republikës së Kosovës, me gjithë

faktin që edhe Presidentja, edhe Ministria e Punëve të Jashtme e dinin fare mirë se këto njohje ende nuk kanë ardhur dhe nuk janë konfirmuar. Paramendojeni, të nderuar deputetë, kur thuhet se na kanë njohur Nigeria, sepse paska vendosur të hapë qendër tregtare në Kosovë. Në qoftë se është ashtu, atëherë na paska njohur edhe Kina, sepse kemi mjaft qendra tregtare me mallra kineze në Kosovë. Këto njohje, me gjithë faktin se MPJ-ja e di se janë të paqena, i vendos në ueb-faqen e saj për t'i mashtruar qytetarët dhe për të ushqyer apetitet e partnerëve të koalicionit.

Ky veprim është në kundërshtim të plotë me çdo praktikë diplomatike, si dhe me Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike dhe Konsullore. Madje, rreziku më i madh janë tendencat e korrupsionit të procesit të njohjeve. Të gjithë tanimë jemi të informuar se edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet ambasadave të tyre në këto dy vende, kanë konfirmuar se këto dy njohje nuk ekzistojnë. Për muaj të tërë, edhe SHBA-të, edhe miqtë tjerë nga Quinti, kanë kërkuar nga MPJ-ja që t'i largojë këto njohje, megjithatë, për shkak, po e them prapë, të apetiteve të partnerëve të koalicionit, kjo nuk është bërë.

Veprimet e tilla tregojnë joseriozitet në politikën e jashtme të Kosovës, madje i dëmtojnë rënd marrëdhëniet bilaterale dhe potencialin që këto shtete dhe shtetet tjera të na njohin vërtet në të ardhmen.

Pyetja këtu është: Kush përfiton nga ky mashtrim i pastër, që po u bëhet qytetarëve të Kosovës? Përgjigjja është: Vetëm 2 ose 3 persona në Qeverinë e Kosovës. Pyetja tjetër është: Kush po dëmtohet më së shumti? Dhe, natyrisht përgjigjja është: Interesat shtetërore të Republikës së Kosovës dhe procesi i shtetndërtimit në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Deklarimet jashtë rendit të ditës u kryen. Vazhdojmë me pikën e dytë:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është kufizuar në 60 minuta. Deputeti në një mbledhje mund të parashtojë më së shumti dy pyetje parlamentare.

Po fillojmë me pyetjen e parë, deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Teuta nuk është këtu, kryeministri nuk është. Vazhdojmë.

Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar. Ministrin e kemi këtu. Deputete e ke fjalën.

KYMETE BYTYÇI: Falemnderit, kryetar!

Duke pasur parasysh rëndësinë e avancimit të Shërbimit Civil të Kosovës, kërkoj nga Ju të më informoni se deri ku janë arritur rezultatet në nxjerrjen e akteve nënligjore që derivojnë nga ligjet për Shërbimin Civil të Kosovës dhe kur do të fillojë të aplikohet procesi i gradimit në bazë të Ligjit për pagat e nëpunësve civilë?

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

MAHIR YAGCILAR: Falemnderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

E nderuara zonja deputete,

Fillimisht, më lejoni të shpreh falënderimet për pyetjen rreth çështjeve shumë të rëndësishme për Administratën Publike.

Ju informoj se deri më tani në zbatimin e legjislacionit primar të Shërbimit Civil, përkatësisht Ligjit për Shërbimin Civil dhe Ligjit për pagat e nëpunësve civilë, nga gjithsej 24 rregullore të parapara janë aprovuar 14 akte nënligjore, të hartuara nga Ministria e Administratës Publike dhe Zyra e Kryeministrit, ndërsa 10 rregullore janë ende të paaprovuara.

Ministria e Administratës Publike e ka për obligim realizimin e aprovimit të tri rregulloreve, si: Projekt-rregullorja për pensionimin e parakohshëm të nëpunësve civilë, që është dërguar në Qeveri për aprovim, Projekt-rregullorja për vlerësimin e rezultateve të punës së nëpunësve civilë, që është në fazën e hartimit në Ministrinë e Administratës Publike, ndërsa Projekt-rregullorja për shtesat mbi pagën bazë dhe kompensimet tjera të nëpunësve civilë është në procedurë për vlerësimin e ndikimit financiar në Ministrinë e Financave.

Ndërsa, shtatë rregulloret tjera, sipas ligjit, duhet të hartohen në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit dhe të miratohen në Qeveri. Sa i përket pjesës së dytë, pyetjes suaj, ju informoj se fillimi i aplikimit të gradimit parashihet të realizohet me Rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. Rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil është aprovuar më 2 mars, sipas së cilës kërkohet që gjatë periudhës 9-mujore, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës të bëjnë klasifikimin e vendeve të punës dhe ta dërgojnë në Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave për marrjen e rekomandimeve për aprovim në Qeveri.

Me aprovimin e klasifikimeve të vendeve të punës, për të gjitha institucionet, pritet që sistemi i ri i pagave në Administratën Publike të fillojë më 1 janar të vitit 2013. Më lejoni ta shfrytëzoj rastin të ju informoj se me ligj dhe me këtë rregullore bëhet kategorizimi i personelit të punësuar në Shërbimin Civil, në katër kategori funksionale: nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, nëpunës civilë të nivelit drejtues, nëpunës civilë të nivelit ekzekutues dhe profesionalë dhe nëpunës civilë të nivelit administrativ. Duke përcaktuar që çdo kategori funksionale e nëpunësve civilë përfshin gradat e punës, të cilat...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit! Deputete, a ke pyetje shtesë?

KYMETE BYTYÇI: Roli i Shërbimit Civil të Kosovës në zhvillimin e vendit tonë dhe në procesin e zbatimit të kriterëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian është i madh, prandaj konsideroj se aplikimi i sistemit të gradimit duhet të jetë prioriteti juaj, në atë mënyrë që ky proces të fillojë të aplikohet, pra siç e thatë, nga janari 2013.

Kjo është e rëndësishme, sepse nëpunësit civilë janë në një situatë të palakmueshme sa u përket pagave dhe se kjo kategori e Administratës Publike meriton trajtim më të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër Yagcilar!

MAHIR YAGCILAR: Po, falemnderit!

Vetëm një si koment. Faktikisht, Rregullorja është aprovuar dhe do të fillojë zbatimin më 1 janar, por nevojitet koha për të gjitha institucionet që të aprovohet nëpërmjet Ministrisë së Administratës Publike dhe vendimit në Qeveri, klasifikimi i vendeve të punës si rregullore për çdo institucion.

Kështu që besojmë që më 1 janar, ose me pagën e janarit, do të bëhet me sistemin e ri sipas ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani. Ministri nuk është këtu, deputete a do ta parashtrosh pyetjen? E ke fjalën.

TIME KADRIJAJ: Falemnderit, kryetar!

Këto ditë nëpër mediet kosovare dhe nga informacione të tjera kemi marrë vesh se drejtori i Qendrës Klinike Universitare ka qenë në pushim në Turqi, të financuar nga një kompani farmaceutike.

Për t'ia shpjeguar opinionit, ky është një konflikt i rëndë interesi. Me këtë, ua toleron kompanive farmaceutike mundësinë e manovrimit nëpër institucionet shëndetësore. Kushtet, përshkrimi i barnave nga kompanitë farmaceutike dhe shpeshherë kjo lidhet me një lloj përqindje sa receta i ke shkruar, aq merr përqindje nga ato receta që i ke shkruar. Deri sot, Ministria nuk ka reaguar ndaj këtij veprimi, e për shkak të këtij konflikti të interesit është dashur që ministri i Shëndetësisë të ndërmarrë ndonjë veprim ndaj tij, ose të suspendohet, ose të largohet krejtësisht nga puna drejtori të Qendrës Klinike Universitare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Goran Marinković, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Deputet, e ke fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Na osnovu statistike i procenta, koji je visok kada je u pitanju nezaposlenost na teritoriji Kosova, a naročito u novoformiranim opštinama, činjenica je da su već duže vreme borimo s tim problemom.

Tako da moram da izrazim zabrinutost, kada je u pitanju održivo zapošljavanje u opštinama gde su srbi većinski zastupljeni.

Projekti, koji imaju za cilj zapošljavanje nisu brojni, a njihov broj mora biti povećan sa naglaskom na novoformirane opštine, koji imaju vrlo limitirane kapacitete zapošljavanja.

Jedan od projekata koji jeste usmeren na zapošljavanje, tako za neodrživo zapošljavanje, koji se implementira već tri godine.

Moje pitanje je, gospodine ministre, šta je konkretno urađeno i koliko je projekata do sad realizovano u opštinama sa većinskim srpskim stanovništvom?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Poštovana zamenice premijera,

Poštovani kolege ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Poštovani gospodine poslanice Marinkoviću,

Možda imam kratko vreme da bih ušao u sve detalje, ali na brzinu ću pokušati da vam objasnim šta je bio zahtev ministarstva od samog početka, pogotovo od prenosa nadležnosti na opštine, koji je bio od samih tih data-baza, koje su bile krejireane i koje su postojale u Ministarstvu za Rad. Trebalo je prebaciti na sve osnovne strukture, koje je opština tek tad pravila i posle sporazuma, koji je potpisan 1 januara 2009. godine, mi smo imali zadatak da postepeno prebacimo sve te nadležnosti.

Jedna od nadležnosti, koje smo trebali da prebacimo je bila i kancelarija za zapošljavanje, koju su pre svega morali tehnički, odnosno kao data-baza da budu premeštene u opštine, a posle toga da se prave strukture, koje su bile logističke strukture u smislu da centri za zapošljavanje moraju da postoje u svim novostvorenim opštinama.

I to je u procesu rešavanja, misleći na to da su već određene kancelarije napravljene, recimo u Gračanici, ove godine već je pri kraju faktički procedura za završetak u Štrpcu i u Partešu. A sledeće godine će taj celokupni proces biti završen, jer smo mi faktički imali novootvorenih negde 7 nova i novoformiranih opština, pa smo morali na sve te da pravilno rasporedimo da sva ta sredstva uložimo.

Ima dva, možda najznačajnija, projekta koja moram da napomenem da se bave pitanjem zapošljavanja. To je projekat održiv za zapošljavanje, ili javni radovi takozvani, koji se finansira od donacija Svetske banke, i takođe drugi projekat koji je "Beautiful Kosovo" ili "Lepo je Kosovo", koji se financira od sredstava Evropske komisije.

Pošto ste vi pitali za prvi projekat, održiv za zapošljavanje, ja ću više o tome reći, ali je bitno da se kaže za projekat "Beautiful Kosovo", da je i on sam ovih dve godine implementacije imao vrednost od 5 miliona evra, koje je takođe vrlo bitno, i od toga je negde za ovih dve godina uložila, ako se ne varam, 650.000 hiljada evra u

новоformiranim opštinama. Ali pošto, kao što rekoh, pričam o projektu održiv za zapošljavanje, ono što mogu da vam kažem da je od 2010. godine, kad je projekat faktički počeo sa realizacijom, mi smo u novoformiranim opštinama, i to Gračanica, Štrpce, ubrojan ovde takođe Ranilug, Parteš, Klokot. Takođe računajući i Priluzje i Šilovo u 2010. godini, imali smo 8 projekata, koji su bili ukupne vrednosti od 270.000 evra; u 2011. godini je bilo 10 projekata sa povećanjem, koja je ukupna vrednost od 647.000 evra.

Ono što je najbitnije što ću da vam kažem u vezi ovih projekata je to da...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit!
Deputet, ke pyetje tjetër?

GORAN MARINKOVIĆ: Da, imam još jedno pitanje.
Takođe me interesuje koji su projekti planirani za 2012. godinu u opštinama gde su srbi većinsko stanovništvo?

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsedniče!
Za ovu godinu je predviđeno da bude čak više projekata, 11 ukupno, čija će vrednost u ovom projektu biti 700.000 evra. A ono što je najbitnije, što sam malo pre hteo da završim, je to što prvi i osnovni kriterijum za sprovođenje ovih projekata je da projekat mora 50% od svoje vrednosti da isplati kroz plate radnike. Što znači da u ovom slučaju, kao što sam rekao, ti projekti će koštati oko 700.000 evra. Od toga će 350.000 ići direktno u ruke građana, koji su pre svega stimulisani da budu oni koji su sa prve one šeme socijalne pomoći. Hvala puno!

KRYETARI: Falemnderit, ministër!
Deputetja Albulenë Haxhiu, pyetje për ministrin e Drejtësisë, përkatësisht zëvendësministrin Hajredin Kuçi. Deputete, e ke fjalën.

Vazhdojmë! Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin e Mjekësisë, Ferid Agani. A do ta bësh pyetjen?

NAZANE BRECA: Falemnderit, kryetar!
I nderuari kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Edhe pse ministri nuk është këtu, unë do ta shtroj pyetjen dhe shpresoj që ai do të gjejë kohë që së paku të përgjigjet me shkrim.

Pyetja ime është e ngjashme me atë të deputetes Time Kadriu. Drejtori i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, në kohën kur është i hapur konkursi për drejtorë klinikash në QKUK, moment ky shumë i rëndësishëm, ai bën pushime në bregdetin turk me një grup mjekësh të qendrës, të cilën ai e drejton.

Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, hotelet dhe akomodimin, për të gjithë grupin e mjekëve i mbulon kompania farmaceutike “Altu-Farma”.

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, në nenin 7, e përcakton shumë mirë se çka është konflikt interesi.

Pyetja ime është: A ka ndonjë shpjegim në lidhje me këtë dhe si do të shpaguhet shpenzimi i agjencisë “Altu-Farma”? Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Nuk kemi pyetje të tjera. Vazhdojmë. Na duhet kuorumi për ta votuar procesverbalin.

Pyetjet parlamentare janë bërë pa interes për deputetët.

Regjia t’i bjerë ziles. Kryetarët e grupeve, është mirë të kujdeseni për kuorumin, pasi na duhet për tri pikat e rendit të ditës. Me kartela i kemi 87, por të pranishëm janë 47 deputetë. Nja dyzet, më tepër janë me kartela.

Deputetët është mirë ta përcjellin, se pasi përfundon pika e dytë e rendit të ditës kërkohet domosdoshmërisht kuorumi për miratimin e procesverbaleve të mbledhjes së kaluar dhe pastaj për miratimin e ligjeve, në lexim të dytë.

Bëhuni më racionalë në shfrytëzimin e kohës.

Tash i kemi 62 deputetë. Mund të vazhdojmë.

Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 1 dhe 7 qershor 2012

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalin e 7 qershorit 2012? Po shihet, nuk ka. Konstatohet se Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 1 dhe 7 qershor 2012.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për persona të verbër dhe persona pjesërisht të verbër

Siç e dini, në mbledhjen plenare të mbajtur më 7 qershor 2012, Kuvendi ka proceduar votimin e 8 amendamenteve në Projektligjin për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër.

Për shkak të dallimeve që kishin Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi, Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa për nivelin e

kompensimit për kategoritë e përfshira, për këtë projektligj, në amendamentin numër 9, Kuvendi në seancën e kaluar i ngarkoi dy komisionet e lartpërmendura që t'i harmonizojnë qëndrimet e tyre.

E ftoj deputeten Suzan Novobërdaliu, kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, që para deputetëve të Kuvendit të deklarojë lidhur me këtë çështje.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Falemnderit, zoti kryetar!

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione duke vepruar në bazë të propozimit të Kuvendit, më 8.6.2012 ka mbajtur takim për t'i shqyrtuar edhe një herë amendamentet 9 dhe 22 të këtij projektligji.

Në këtë takim ka marrë pjesë edhe kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe, pas një diskutimi, komisioni ka marrë qëndrim që të tërhiqet nga amendamenti 9, i propozuar nga komisioni ynë, si dhe nga amendamenti 22.

Amendamenti 9 do të jetë vetëm propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe do të ngelë i njëjtë, përpos fjalës “pension”, që do të zëvendësohet me “kompensim”, si dhe do të shtohet fjalia “Kompensimi indeksitet me rritje të pagës minimale në Kosovë”. Këtë e ka thënë kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa edhe në seancën e kaluar.

Njëherësh, propozojmë që në amendamentin 5, neni 3, paragrafi 1.2, fjala “pension” të zëvendësohet me fjalën “kompensim”. Falemnderit, kryetar!

Amendamentet tjera ngelin të njëjta.

KRYETARI: Deputete, kryetare e Komisionit për Buxhet dhe Financa, e do fjalën? Jo. Vazhdojmë!

Po, megjithatë, ne e kemi votuar amendamentin e pestë. A jeni dakord që fjala “pension” të zëvendësohet me fjalën “kompensim”, siç është në amendamentin 9.

Atëherë konsideroj se Kuvendi është dakord që fjala “pension” të zëvendësohet me fjalën “kompensim”. Një votim formal, ju lutem!

Falemnderit! A ka kundër? Jo, me vota vendoset. A ka kundër? Dy vota. Falemnderit! Shumica absolute e aprovoi.

Vazhdojmë me amendamentin e nëntë!

(Ndërhyrje)

Ne po votojmë atë që ka kërkuar komisioni dhe, ju lutem, ne e votuam.

(Ndërhyrje)

Ju lutem, e kryem.

Vazhdojmë me amendamentin e nëntë, me propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe me pajtimin e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash!

Amendamenti 9

I kemi kryer diskutimet për amendamentet e këtij ligji. Tani votojmë!

(Ndërhyrje)

Ju lutem, në fund, pasi ta votojmë, mund ta arsyetoni qëndrimin.

Me 54 vota për, 4 kundër, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

A ka kundër?

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka

Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Sa janë? Atëherë, votojmë në mënyrë elektronike! Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash për amendamentin 21.

Në sallë janë të pranishëm 78 deputetë.

59 për, 8 kundër, 2 abstenime. Miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22. U tërhoq? Mirë.

Amendamenti 23

A ka kundër?

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 25
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Tani e votojmë ligjin në tërësi!

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 66 vota për, 8 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për persona të verbër dhe persona pjesërisht të verbër.

“Vetëvendosja”, mund të deklaroni pse keni votuar kundër.

Ju keni të drejtë edhe në fund ta deklaroni votën e juaj. Si tash, si atëherë, e njëjta gjë është.

Mirë, vazhdojmë! Amendamentet i kemi debatuar në seancën e kaluar.

Falemnderit shumë!

Pika e pestë:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit, e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, e ka hartuar raportin me rekomandime, të cilin ju e keni përpara.

Raportin me rekomandime në fazën e parë, kur e kemi miratuar, Komisioni për Legjislacion na ka dhënë një sugjerim, që neni 4 i Projektligjit dhe amendamenti 6 të rikthehen për rishqyrtim. Ne e kemi mbajtur mbledhjen më 12.6.2012, e kemi shqyrtuar vërejtjen, e cila na ka ardhur nga Komisioni për Legjislacion dhe kemi bërë plotësim-ndryshimin e amendamentit 6, që ka të bëjë me nenin 4 dhe e kemi riformuluar

amendamentin. Kështu që, në këtë formë siç është paraqitur, siç e keni në rekomandime, është përkrahur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa me shumicë votash.

Prandaj, rekomandoj deputetët që të gjitha amendamentet, të cilat i ka propozuar Komisioni për Buxhet dhe Financa, t'i miratojnë, sepse janë miratuar edhe në komision dhe janë në harmoni me legjislacionet në fuqi.

KRYETARI: Falemnderit! Arben Gashi, kryetar i Komisionit për Legjislacion, e ka kërkuar fjalën.

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryetar!

Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa e konstatoi vendimin që Komisioni për Legjislacion e ka nxjerrë dhe në vendimin e Komisionit për Legjislacion thuhet se amendamenti i gjashtë, i cili merret me nenin 4, të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse në atë amendament thuhet: “Në rast të konfliktit të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, me ligjet e tjera në Kosovë, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, në çdo kohë, është mbi çdo ligj tjetër”. Dhe, ky formulim ka qenë në kundërshtim me frymën e Kushtetutës dhe në konflikt, po ashtu, me ligjet tjera, sepse vendos një sipërmarrësi të një ligji mbi ligjet tjera.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka bërë një ndryshim, ndryshim të cilin Komisioni për Legjislacion nuk ka pasur kohë ta trajtojë, prandaj i mbetet seancës që të vendosë.

Është hequr fjala “ka përparësi mbi çdo ligj në çdo kohë” dhe është varianti që tashmë ka mbetur, për të cilin seanca duhet të marrë vendim, sepse Komisioni për Legjislacion nuk ka pasur mundësi ta ritrajtojë këtë nen. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Visar Ymeri. Të pranishëm janë 74 deputetë, kurse me kartela janë 90 deputetë, prandaj propozoj t'i hiqni kartelat e deputetëve që nuk janë të pranishëm. Fjalën tash e ka Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit kryetar!

Së pari dua të bëj një vërejtje goxha thelbësore, për mendimin tim, për mënyrën se si po udhëhiqet nganjëherë seanca. Nuk është e udhës, e as e drejtë t'u ndërpritet fjala deputetëve kur duan ta arsyetojnë votimin paraprak për ndonjë amendament të caktuar...

KRYETARI: Të lutem, përqendrohu në rend të ditës!

VISAR YMERI: Kryetar, amendamenti për të cilin pak më parë ka ndryshuar, rrjedhimisht ne kemi të drejtë ta shfaqim mendimin tonë për atë amendament. Dhe, nuk jam jashtë rendit të ditës, sepse po flasim për këtë çështje.

Nëse je për ngut, e ke për të shkuar diku, në rregull - tregona, e të zëvendëson ndokush, por mos na e ngut seancën.

Deputetët kanë të drejtë ta marrin fjalën dhe ta shpjegojnë qëndrimin e tyre në secilin moment, sepse këtu po flasim për ligje.

KRYETARI: Unë të lejoj të flasësh, por nuk je duke folur sipas rendit të ditës.

VISAR YMERI: Jo, kjo është tamam në rend të ditës.

KRYETARI: Jo, nuk është hiç në rend të ditës.

VISAR YMERI: E dyta, po flasim për Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

KRYETARI: Dhe, është mirë të disiplinoheni vetë!

VISAR YMERI: I kemi tri vërejtje thelbësore për këtë. Vërejtja e parë është te amendamenti numër 3. Nuk e di a e keni parë dhe nëse u është përvjedhur kjo deputetëve, por kur ndryshohet përkufizimi i Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, në fakt kur hiqet ky përkufizim, nuk hiqet vetëm Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, por hiqet edhe Kuvendi, për shkak se në ligjin origjinal, që po e lexoj tash, thuhet kështu: “PCN do të thotë Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, ose në mungesë të tij, Kuvendi”. Dhe, në amendamentime kjo fshihet, pra fshihet Kuvendi.

Pra, a po nënkuptuak se përmbyllja e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës do të rezultojë në fund edhe me heqjen fare të Kuvendit, e ta kemi vetëm Qeverinë, edhe buxhetin, edhe aparatën shtetëror.

Vërejtja e dytë është te asistencë emergjente e likuiditetit, e cila shtohet edhe si përkufizim, por edhe si nen. Për këtë asistencë tregohet se si do të menaxhohet, se si do të jetë pjesë e fondit të konsoliduar të Kosovës, se si do të menaxhohet në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës, por nuk shpjegohet, e ndoshta ligji nuk duhet ta shpjegojë këtë, por ministri do të mundte ta shpjegonte se për çfarë do të përdoret kjo asistencë.

Atëherë, a është kjo asistencë, e cila do ta garantojë një likuiditet të sistemit financiar, pra kryesisht të sektorit bankar, në momentet e krizës së këtij sektori; a është ky fond pjesë e parasë publike të Kosovës, që do të përdoret për ta mirëmbajtur një sektor bankar për të cilin të gjithë jemi dakorduar tashmë se më shumë po e dëmton, se sa po e ndihmon ekonominë e Kosovës. Pra, a do të përdoren paratë e qytetarëve të Kosovës për t’ua financuar profitin jashtëzakonisht të lartë bankave komerciale në Kosovë, ose a do të jetë ky fond - fond i cili do t’i garantojë depozitat e qytetarëve. Pra, njëra ose tjetra është kështu.

Dhe, sipas mënyrës si është shkruar në ligj, ky do të jetë fond, i cili do të përdoret për përmbushjen e kriterëve të likuiditetit dhe nevojës së likuiditetit në sektorin financiar, pavarësisht si rezultojnë ato dhe prej nga vijnë. Pra, në njëfarë mënyre, është një lloj fondi që e garanton dhe inkurajon edhe një papërgjegjësi më të madhe të bankave

komerciale në menaxhimin e parave që janë të qytetarëve të Kosovës, si depozita, e po ashtu edhe kredi.

Dhe, çështja e tretë ka të bëjë natyrisht me amendamentin 6, për të cilin u fol këtu, edhe pse i riformuluar, për shkak se në versionin e tij fillestar arbitrariteti qeveritar në të ka qenë jashtëzakonisht i dukshëm, por tash është kamufluar disi, prapëseprapë ky amendament e bën një lloj kalimi, një lloj hapi goxha cilësor drejt krijimit të një shteti 100% nën kontrollin e Qeverisë, pa kurrfarë mbikëqyrje nga askush tjetër. Për shkak se me këtë amendament, pra me këtë nen dhe me këtë ligj, në përgjithësi, duke pasur parasysh se ingerencat kryesore për ligjin i kanë ose ministri i Financave, ose kryeministri, pra kur hiqet Kuvendi, dhe tash nëse i japim supremaci këtij ligji karshi të gjitha ligjeve tjera, në arbitraritet me ministër për të vendosur se kur dhe si do të suspendohen ligjet tjera, atëherë Kosovës më vërtet nuk do t'i duhet as Kuvendi, e as përpjekja për të miratuar ligje për shkak se do të jetë në mëshirën e ministrit, në fund të fundit, që të përcaktojë nëse një ligj do të zbatohet apo jo, karshi problemeve dhe rrjedhave financiare e fiskale që i kemi në vend.

Pra, edhe kjo, përveç arbitraritetit të Qeverisë, e garanton një lloj moskokëçarjeje dhe papërgjegjësie nga Qeveria, për shkak se kur ta dimë paraprakisht se mund të keqshpenzojnë dhe pastaj t'ua ndalin, ta zëmë, pensionin qytetarëve të Kosovës, pra t'ia ndalin rrogat administratës publike, t'i ndalin të gjitha shpenzimet tjera, siç këta kanë dëshirë, atëherë do të jetë 100% në kompetencën e tyre dhe në fuqinë e tyre politike që të vendosin se cilat ligje kur do të zbatohen. Dhe, konsideroj se kjo është në kundërshtim të plotë me termin Republikë dhe rregullimin shtetëror Republikë, të cilin në Kosovë po duam ta ndërtojmë.

Pra, kjo shpërfillje e Kuvendit, e cila deri tash është bërë duke i shkelur procedurat, po tentohet që edhe me këtë ligj të legalizohet. Pra, shkelja dhe shpërfillja e Kuvendit të bëhet procedurale.

Prandaj, ne jemi absolutisht kundër këtij ligji, me këto amendamente, për shkak të arsyeve që i përmendëm.

KRYETARI: Falemnderit! Por, ju, në fillim, kërkuat që një personi, do të thotë Presidentit t'i jepen kompetenca legjislative. Është mirë t'i harmonizoni qëndrimet. Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj.

(Ndërhyrje)

SAFETE HADËRGJONAJ: Kryetar, unë në fakt nuk e kërkoja fjalën. Unë thashë se amendamentet të cilat i ka propozuar komisioni janë të harmonizuara dhe të votuara në komision. Ne nuk kemi bërë ndonjë amendament ku e kemi hequr Kuvendin, sepse kjo ka ardhur me propozimet e ligjit, i cili ka kaluar në lexim të parë, te neni 1, te përkufizimet, është fshirë PCN-ja, kurse tjerat nuk janë fshirë. Këtu nuk është fshirë asgjë tjetër dhe është miratuar në lexim të parë. Ne nuk kemi bërë ndryshime në amendamente. Ne vetëm e kemi shtuar në fakt pikën 2 në nenin 1.1 të ligjit bazik. E kemi sqaruar që pas përkufizimit “ndërmarrje” të shtohet një përkufizim si vijon: AEL, që nënkupton

asistencë emergjente të likuiditetit. Domethënë, kemi dhënë sqarim që pas përkufizimit “ndërmarrje” të shënohet ky përkufizimi i ri, kurse nuk kemi hequr asgjë nga ajo që ka qenë e miratuar në lexim të parë. Domethënë, nuk kemi bërë ndryshime, nuk kemi fshirë as Kuvend, asnjë gjë tjetër.

Kurse sa u përket neneve tjera, në këto amendamente që i kemi propozuar nuk kemi ndërhyrë në çështje, të cilat u diskutuan këtu. Jemi përpjekur të bëjmë rregullimet e mundshme dhe u rekomandoj deputetëve t’i miratojnë.

KRYETARI: Replikë, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit! Së pari, kryetar, ne nuk kërkuam që Presidentja ta ndryshojë ligjin, por ta kthejë në Kuvend. Pra, ka njëfarë dallimi thelbësor në këtë.

Dhe e dyta, kërkuam që Ligji për ndërtim të kthehet në Kuvend, meqenëse është në kundërshtim me Kushtetutën, duke pasur parasysh se siguria e qytetarëve është kategori kushtetuese. Pra, është 100% përbrenda kompetencave të Presidentes, e nuk krahasohen këto dy momente, për të cilat po flasim tash.

Me ligjin, ose me plotësim-ndryshimin e ligjit, të cilin po e shohim këtu, Kuvendi tentohet të shpërfilllet. Ne nuk kërkuam që të shpërfilllet Kuvendi me Ligjin për ndërtim, por thamë ta kthejmë edhe një herë në Kuvend dhe ta rishqyrtojmë.

E dyta, sa i përket asaj se a është fshirë apo jo, unë e lexova shumë qartë përkufizimin dhe aty shumë qartë thuhet: “Ose, në mungesë të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar është Kuvendi”, e kjo është fshirë tërësisht. Tash po, është fshirë nga Qeveria, është e vërtetë. Nuk e ka fshirë komisioni, por kjo nuk ka fare rëndësi se ne do ta votojmë sot një amendamentim, i cili do ta lërë këtë heqje të Kuvendit nga ky përkufizim, do ta lërë anash. Pra, nuk do ta përmendë fare.

E, ky ligj është miratuar si pjesë e pakos së Ahtisarit, me procedurë të përsheptuar, e kështu me radhë. Dhe mënyra si lexohet ky përkufizim është menduar atëherë, si duket, e këtë e dini më mirë sigurisht ju që e keni votuar këtë ligj sesa unë, që kur të hiqet Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar të zëvendësohet me Kuvendin. E tash çfarë po ndodh? Po hiqet Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, e po zëvendësohet me Qeverinë.

Ky është dallim thelbësor. Juve mund të ju duket formal, por është dallim thelbësor, për shkak se Kuvendi po anashkalohet edhe në një sektor shumë të rëndësishëm të financave publike.

Në anën tjetër, po ashtu, te amendamenti i asistencës emergjente, në Ligjin për financat publike, deri tash është thënë që nuk ka të drejtë Qeveria të krijojë kurrfarë fondesh të reja dhe me këtë arsyetim u është thënë edhe pensionistëve - nuk mund të krijojmë fond pensional, u është thënë edhe fondeve tjera, fondit të papunësisë, fondit të sigurimeve shëndetësore, nuk na lejon ligji të formojmë fonde tjera...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit! Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Dëshiroj të ndërlidhem me diskutimin e kolegut. Jo më larg se javën e ardhshme, ndoshta, Kuvendi do ta debatojë Ligjin për përmbylljen e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë dhe në atë ligj çdo kund ku përmendet prania civile ndërkombëtare, kompetencat do të transferohen te organet përkatëse kushtetuese. Pra, do të jetë një ligj, i cili do t'i bartë këto kompetenca ose te Kuvendi, ose te Qeveria, varësisht nga natyra e kompetencave kushtetuese dhe të jeni të sigurt se, jo vetëm 22 ligje, por komplet Legjislacioni do të spastrohet, sepse pas tërheqjes së mbikëqyrjes ndërkombëtare komplet autoritetet kushtetuese të PCN-së kalojnë ose te Kuvendi, ose te Qeveria, varësisht nga kompetencat kushtetuese të këtyre organeve. Kështu që me atë ligj do të bëhet pastrimi, nëse në këtë ligj nuk është bërë bartja adekuate e kompetencave, me atë ligj do të barten disa kompetenca te Kuvendi, disa te Qeveria, dhe në një mënyrë nuk do të ketë referenca për PCN-në në ligjet e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka nënkryetari, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zotni kryetar!

Lidhur me këto amendamente, u panë qëndrimet, edhe të komisioneve, edhe kryesisht të “Vetëvendosjes” dhe unë nuk kam ndonjë interpretim. Por, në diskutime u kalua në çështje parimore, që lidhen me deputetët, me votimet dhe me këtë Kuvend. Këtu e kam parasysh edhe atë që kolegu Bajrami e artikuloi.

Zëvendësimi i institucioneve ndërkombëtare me të Kosovës nuk do të thotë që zëvendësimi të kalojë nga një institucion te tjetri. Këtu është problemi, sa pashë unë, themelor. Dhe, e dyta, nëse deputetët kanë ardhur në gjendje që të ndikohen, jo nga interesat e zgjedhësve të vet, por nga zyrat e brendshme apo të jashtme, është problem i tyre që e kanë humbur fuqinë e arsyetimit dhe të rezonimit të tyre, prandaj le të ankohen në vetveten, e jo në askënd tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe pse ndoshta diskutimet në lexim të dytë duhej të ishin të atyre që bëjnë amendamente, ne nganjëherë po lëmë edhe mundësi të tjera. Realisht, të drejtën për të arsyetuar amendamente në lexim të dytë e kanë ata që kanë bërë amendamente. Vazhdojmë.

Prania në sallë është 77 deputetë. I votojmë amendamentet.

Amendamenti 1

A ka kundër?

Abstenim, nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër, nuk ka? Abstenim, 1. Miratohet.

Amendamenti 3

Votojmë me elektronikë. Lus deputetët e regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Të pranishëm janë 81 deputetë.

Me 57 vota për, 10 kundër dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

A ka kundër?

Abstenim, nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Do të votojmë me elektronikë dhe votojmë tash për amendamentin 5.

Me 57 vota për, 10 kundër dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6, me vërejtjet e Komisionit për Legjislacion. Votojmë me elektronikë dhe votojmë tash:

Me 59 vota për, 9 kundër dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Të pranishëm janë 81 deputetë.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë Ligjin në tërësi.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 60 vota për, 8 kundër dhe 6 abstenime, miratohet Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Dhe, me këtë, e kemi përfunduar seancën e sotme. Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia për Transkript dhe Lekturë